



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT MBI GJENDJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË VENDET PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

TETOR – DHJETOR 2008

Hyrje

1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH-ja), organizata e parë e të drejtave të njeriut e krijuar në vitin 1990 ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve. Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar është një nga fushat kryesore të vëzhgimeve të KSHH-së.

2. Gjatë periudhës tetor - dhjetor 2008, KShH realizoi vëzhgime në institucionet e paraburgimit: “Jordan Misja” në Tiranë, “Mine Peza” në Tiranë, Berat, Durrës, Vlorë, si edhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim “Shën Koll” Lezhë, Vaqarr, Fushë-Krujë, Krujë, “Ali Demi” në Tiranë dhe Spitali i Burgjeve në Tiranë. Misionet e monitorimit janë mundësuar falë mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit në kuadër të veprimtarive të zhvilluara “Për një respektim më të mirë të të drejtave të viktimave në Shqipëri”

3. Qëllimi i monitorimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të personave të paraburgosur në përgjithësi, i kushteve fizike të jetesës nëpër institucione, i atmosferës së përgjithshme që mbizotëronte në këto institucione, kujdesi social dhe shëndetësor që ofrohej në këto institucione, si edhe aspekte të tjera që lidhen me të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve në përgjithësi.

4. Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet minimale ndërkombëtare, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar, më konkretisht në Kushtetutën e R. SH-së, Kodi e Procedurës Penale, ligjin nr. 8328, datë 16.04.1988, “Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, Rregulloren “Për policinë e burgjeve”, Rregullorja e paraburgimit e vitit 2006. Rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës për Shqipërinë, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të KShH-së u mbajtën gjithashtu parasysh.

5. Gjatë vëzhgimeve u morën takime të drejtpërdrejta me të paraburgosurit, drejtuesit e institucioneve të paraburgimit, përgjegjësit dhe specialistët e sektorëve të sigurisë, të kujdesit social dhe sektorit juridik, shëndetësorë dhe të personelit. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KShH-së me profesion juristë dhe mjekë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

6. Raporti paraqet problemet më të përgjithshme të konstatuara në institucionet e vëzhguara. Gjatë vëzhgimeve, vëzhguesit e KShH-së patën mundësi të marrin takime me të paraburgosurit dhe të dënuarit dhe të komunikojë lirshëm me ta.

7. Mbipopullimi ishte një problem shqetësues pothuajse në të gjitha institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim të vëzhguara nga KShH-ja, sidomos në institucionin e vujatjes së dënimit Rrogozhinë, Lushnjë, në institucionin e paraburgimit Durrës. Mbipopullimi ishte shqetësues në sektorin e paraburgimit “Jordan Misja”, Tiranë dhe në sektorin e të dënuarve në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim “Ali Demi”, Tiranë. Për gjendjen e konstatuar KShH ka reaguar me anë të letrave të hapura dhe deklaratave publike.

8. Infrastruktura e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucioneve dhe mundësitë që ato krijojnë për një jetë normale për personat e privuar nga liria ishin gjithashtu objekt vëzhgimi. Gjatë vëzhgimeve të kryera u konstatua përmirësime të infrastrukturës së ambienteve të disa institucioneve të vëzhguara. Probleme kishte në disa nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP), si edhe në disa nga institucionet e paraburgimit (IP) të kaluar rishtazi në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Në disa prej tyre kishte mungesë të energjisë elektrike dhe të ujit të rrjedhshëm 24 orësh dhe godinat ishin totalisht të amortizuara dhe me lagështirë (IEVP “Ali Demi” Tiranë, IP Durrës, IP Berat, IEVP Rrogozhinë, IP “Jordan Misja” Tiranë, kryesisht kati i parë, IEVP Lushnje), gjë që ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e personave të privuar nga liria.

9. Thuajse në të gjitha vendet e vizituara, kushtet e infrastrukturës nuk ofronin mundësitë reale për të përballuar mbipopullimin, për rrjedhojë nuk respektohej hapësira ose kubatura që duhet të ketë çdo person i privuar nga liria. Në IEVP Rrogozhinë dhe në IEVP Burrel, në sektorin e paraburgimit, në një dhomë mund të qëndronin nga 6 deri në 12 vetë.

10. Një tjetër problem i evidentuar si shqetësues ishin rrugët që të çonin në IEVP në Krujë dhe IEVP në Lushnje. Amortizimi i tejskajshëm i tyre krijonte shumë probleme për mbarëvajtjen e punës në institucion (furnizimeve të përditshme, shoqërimeve për në gjykata, për urgjencat shëndetësore), por edhe për familjarët që vinin për të vizituar të afërmit e tyre në këto institucione.

11. Higjiena e ambienteve të brendshme ishte një tjetër problem i konstatuar në disa prej institucioneve të vëzhguara, e shkaktuar nga mungesa i ujit të rrjedhshëm dhe e energjisë elektrike 24 orëshe. Në disa prej institucioneve nuk funksiononin dushet e përbashkëta. Të paraburgosurit dhe të dënuarit laheshin në kushte jo të përshtatshme.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

12. Nga vëzhgimet e kryera u konstatua një gjendje jo e mirë e pajisjeve të përdorimit vetjak të personave të privuar nga liria si: dyshekë, jastëkë ose pajisje të tjera të cilat për arsye të amortizimit dhe të keqpërdorimit ishin në gjendje jo të mirë. Shumica e personave të privuar i siguronin teshat personale nëpërmjet familjarëve të tyre. Në momentin e vëzhgimit në IP Durrës mungonin totalisht dhe të paraburgosurit flinin në dysHEME.

13. Një problem shqetësues mbetet mbipopullimi në Qendrën Spitalore të Burgjeve, i cili ndikohet nga fakti se ende në këtë spital mbahen personat me probleme mendore si edhe një pjesë e personave që kanë nevojë për kujdes të veçantë.

14. Pavarësisht faktit se nga KShH-ja e ka ngritur shpeshherë si problem, ende shfaqet shqetësues gjendja në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Ali Demi” Tiranë. Në seksionin ku mbahen gratë dhe vajzat e dënuara, kushtet fizike të godinës janë tejet të amortizuara, me lagështirë dhe të papërshtatshme për të përballuar mbipopullimin e lartë me të cilin përballlet ky institucion. Shqetësues është gjendja e nyjave sanitare të këtij regjimi, mbi të cilat nuk është bërë asnjë investim tashmë prej vitesh.

15. Norma ushqimore që iu ofrohej personave të privuar nga liria përmbushte kërkesat e normativës ditore ushqimore. Gjithashtu zbatohet një normë e veçantë ushqimore për personat që punonin dhe për të sëmurët diabetikë, duke respektuar kërkesat specifike dietike të këtij grupi personash të privuar nga liria. Megjithatë, nga konstatimet në terren u vu re një pjesë e personave të privuar nga liria nuk e merrnin ushqimin e ofruar nga institucioni dhe parapëlqenin ushqimin e siguar nga familjarët e tyre. Arsyet ishin të ndryshme si: ekzistenca e një mentaliteti që lidhej me ushqimin që ofronte institucioni, personat e kontaktuar pretendonin se disa ushqime (orizi, fasulja) ishin të vjetra, mënyra e gatimit dhe shpërndarjes së tij ishte jo e përshtatshme.

16. Punësimi i personave të privuar nga liria ishte në vëmendje të vëzhgimit. Në disa nga institucionet e vëzhguara kishte persona të punësuar në punë të tilla si: pastrim, mirëmbajtje, kuzhinë dhe në punë tjera. Në institucioni e ekzekutimit të dënimit me burgim “Shën Koll”, Lezhë kishte rreth 200 të dënuar të punësuar. Problem shqetësues ishte mosnjohja e ditëve të punës për efekt dënimi në IEVP Burrel, i vetmi i institucionit ku nuk zbatohet ligji, si edhe pagesa e vogël e të punësuarve të privuar nga liria, e cila bazohej në sistemin e vjetër të pagesës që ende zbatohet në sistemin e burgjeve shqiptare (SBSH). Deri më sot nuk është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave për pagesën e përshtatshme të punës së të dënuarve.

17. Shërbimi shëndetësor ishte një tjetër aspekt i vëzhguar nga grupi i vëzhgimit të KShH-së. Në institucionet e vëzhguara kishte shërbim shëndetësor funksional 24 orësh. Farmacitë e institucioneve kishte gjendje medikamente mjekësore. Të paraburgosurit dhe



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të dënuarit ishin të kartelizuar, si edhe kishte evidenca mjekësore për të sëmurët me sëmundje të ndryshme. Të paraburgosurve dhe të dënuarve u lejohej të zgjidhnin edhe shërbim mjekësor jashtë institucioneve të tyre, por procedura e miratimit të kësaj kërkesë ishte tejet e zgjatur, gjë e cila e bënte shumë të vështirë miratimin e saj.

18. Në disa prej këtyre institucioneve të vëzhguara problem shqetësues ishte shërbimi stomatologjik. Në IEVP Fushë-Krujë mungonin totalisht pajisjet stomatologjike, dhe medikamentet e këtij shërbimi. Personat me probleme stomatologjike dërgoheshin jashtë institucionit për të marrë këtë shërbim. Edhe në IEVP Krujë ky shërbim ishte vetëm 3 herë në javë, ndërsa në IEVP Burrel 2 herë në javë, ç'ka kufizonte kujdesin për këtë shërbim mjekësor.

19. Mungesa e stafit mjekësor dhe sanitar të mjaftueshëm ishte një tjetër aspekt i cili krijonte mbingarkesë të stafit ekzistues si edhe ndikonte drejtpërdrejtë në përballimin e punës së këtij shërbimi. Ky problem u evidentua në IEVP "Shën Koll" Lezhë, në të cilin punonin vetëm një mjek i përgjithshëm dhe 4 infermierë me rreth 800 të paraburgosur dhe të dënuar; në IEVP Fushë-Krujë, ku përveç shërbimit mjekësor ofrohej edhe shërbim sanitar për të sëmurët me probleme dhe invalidët; në IEVP "Ali Demi" ku mungonte mjeku gjinekolog (edhe pse kishte një akt-marrëveshje të DPB-se dhe ASHR-së, që mjek gjinekolog nga ambulanca nr. 4. do të bënte së paku një herë në javë vizita gjinekologjike në institucion, në realitet kjo marrëveshje nuk ka funksionuar). Një tjetër problem real, i ngritur nga drejtuesit e institucioneve të vëzhguara ishte edhe punësimi i mjekëve, stomatologëve dhe stafit tjetër mjekësor, pasi nuk kishte persona që dëshironin të punonin në këto institucione.

20. Shërbimi i kujdesit social dhe edukativ janë elementë të rëndësishëm të rehabilitimit të të dënuarve. Në të gjitha institucionet e vëzhguara nga sektori i kujdesit social ishin plotësuar dosjet psiko-sociale për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, si edhe pjesa tjetër e dokumentacionit bashkëshoqërues. Pavarësisht kësaj, në institucione si ai i Fushë-Krujës dhomat e kujdesit social ishin të pa pajisjeve që lehtësojnë punën e specialistëve të këtij shërbimi si edhe mungonin ambientet sportive ku të paraburgosurit dhe të dënuarit të mund të zhvillonin aktivitete sportive, të cilat aktualisht i kryenin në ambientet e ajrimit.

21. Bibliotekat në çdo institucion të vëzhguar ishin të varfëra në libra dhe kishin nevojë të rinovoheshin, sidomos me literaturë juridike dhe sociale. Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale "Shën Koll" Lezhë, Vaqarr, Burrel kishte mungesa të zhvillimit të programeve specifike për grupe të veçanta që kanë nevojë për një trajtim më të specializuar. Në shumicën e institucioneve të vëzhguara kishte mungesa të zhvillimit të kurseve profesionale për personat e privuar nga liria.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

22. Objekt vëzhgimi ishte monitorimi i së drejtës së kontaktit me familjarët dhe të afërmit dhe e lidhjeve me jashtë të personave të privuar nga liria. Nga vëzhgimet e kryera dhe nga intervistat e marra në terren, rezultoi se kjo e drejtë në përgjithësi respektohej. Ata kishin të drejtën e dy telefonatave në javë dhe të katër takimeve në muaj, por pavarësisht këtij rregulli ekzistonte mundësia e telefonatave ose të takimeve shtesë, me miratimin e drejtorit të institucionit. Një problem i evidentuar në këtë aspekt ishin ambientet e realizimit të takimeve me familjarët, të cilat në disa institucione ishin të papërshtatshme dhe pa mundësi kontakti me ta (në IEVP Fushë-Krujë ambientet e takimit për të dënuarit me siguri të zakonshme, ndërsa për të dënuarit me siguri të lartë takimet zhvilloheshin në një dhomë normale). Në IEVP “Shën Koll” në Lezhë nuk funksiononte sistemi i kutive postare, gjë e cila krijon zvarritje të panevojshme ç’ka cënon të drejtën ligjore të të dënuarve për mbajtjen e kontakteve me jashtë.

23. Zbatimi i masave disiplinore të dhëna nga Komisioni Disiplinor i institucioneve të vëzhguara, për kryerjen e shkeljeve disiplinore të kryera nga personat e privuar nga liria, funksiononte sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjithsesi, nga intervistat e marra nga grupi i vëzhgimit të KShH-së nga të paraburgosurit u ngritën problemet e mosnjohimit të tyre për marrjen e masës disiplinore (në institucionin e Fushë-Krujës); u ngrit gjithashtu problemi i mos heqjes së masës disiplinore nga dosja e të paraburgosurve ose të dënuarve, pas kalimit të afatit 6 mujor të saj, në rast mos përsëritjeje të shkeljes disiplinore. Ky fakt ndikonte negativisht në uljet e dënimit që jep gjykata për ta. Një problem i tillë u theksua sidomos në IEVP ‘Shën Koll’ Lezhë.

24. E drejta e kërkesë-ankesave të personave të privuar nga liria është e njohur në legjislacionin shqiptar në këtë fushë. Nga vëzhgimet në terren si edhe nga monitorimi i procedurave të mekanizmit të kërkesë – ankesës nëpër institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale, rezultoi se kjo e drejtë realizohej. Grupi i vëzhgimit evidentoi probleme si: zvarritje në kthimit të përgjigjeve nga sektorët e brendshëm të institucionit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, i ngritur nga shumë persona të privuar nga liria. Personat e intervistuar u evidentua qartë edhe një atmosferë mosbesimi lidhur me zgjidhjet e mundshme të kërkesave apo ankesave të tyre, gjë e cila u vu re më së shumti në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të Fushë-Krujës.

25. Nga konstatimet në terren u evidentua mungesa e një mekanizmi kontrolli të unifikuar në të gjitha institucionet e vëzhguara, lidhur me kthimin e përgjigjeve nga ana e sektorëve të ndryshëm, për kërkesë-ankesat e personave të privuar nga liria. Në përgjithësi, drejtori i institucionit i linte detyrë sektorit të kujdesit social që të monitoronte kthimin e përgjigjeve, kryesisht të përgjigjeve që duhet te jepeshin nga sektorit juridik, gjë që bie ndesh me qëllimin e punës së sektorit të kujdesit social.

26. Nga kontakti me personelin e zyrës juridike, grupet e vëzhgimit mësuan se kishte vonesa në nxjerrjen e urdhrat për ekzekutimin e vendimit nga e prokurorisë. Sipas tyre, në



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

disa raste urdhrat e ekzekutimit janë të paqarta dhe evazive veçanërisht çka shkaktonte konfuzion të përfaqësuesve të zyrës juridike, veçanërisht në rastet e personave ndaj të cilëve ka akuza për më shumë se një vepër penale. Gjithashtu probleme u evidentuan me afatet e gjata të paraburgimit për personat e arrestuar.

27. Mangësi u evidentuan edhe në mbajtjen e lidhjeve midis të dënuarve dhe përfaqësuesve të sektorit juridik. Sipas personelit të këtij sektori, kjo gjendje shkaktonte për shkak të fluksit të punës në këtë sektor i cili me mjaft vështirësi përballohej shpeshherë nga një person i vetëm. Megjithatë, KSHH e sheh të nevojshme të ividentojë dhe nivelin profesional dhe pervojën e pakët të një pjesë të stafit të këtij sektori.

28. Të dënuarit e kontaktuar shfaqën ankesa në lidhje me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për lirim me kusht ose ulje të dënimit. Në lidhje me lirimin me kusht, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, siç rezultoi edhe nga vëzhgimet në institucione të ndryshme, ka interpretime të ndryshme nga ana e gjykatës të termit "arsye të veçanta".

29. Nga grupi vëzhgimit të KShH-së u vëzhguan edhe dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit konstatimet në terren rezultoi se kushtet fizike të këtyre ambienteve ishin jo të mira, pa pajisjet e nevojshme për akomodim, pa dritë të mjaftueshme natyrale. Në mjediset e ndalimit dhe të shoqërimit në Komisaratin e Vlorës këto dhoma nuk kishin asnjë pajisje të nevojshme për qëndrimin 10 orësh të personave të shoqëruar. Mungesa totale e ajrimit si edhe infrastruktura e vjetruar kishin shkaktuar një shkallë të lartë lagështire.

30. Një tjetër problem i konstatuar në terren, ishin shkeljet për qëndrimin mbi afatet e përcaktuara ligjore të personave në mjediset e komisarateve. Nga intervistat e marra nga personeli i këtyre komisarateve u evidentuan vonesa nga DPB për nxjerrjen e shkresave ku përcaktohet institucionin i ekzekutimit të vendimeve penale, ku personi i privuar nga liria do të transferohet. Në Komisaratin e Vlorës nuk kishte ambiente të veçanta për ndalimin e personave të mitur ose të grave dhe vajzave. Pozitiv ishte fakti se në këtë institucion personave të mitur u sigurohej prezenca e prindit si dhe ajo e psikologut nëpërmjet bashkëpunimit më Drejtorinë e Policisë së Qarkut.

31. Për t'u evidentuar ishte fakti që një i ndaluar në komisaratin e Burrelit kishte 3 vakte pa ngrënë ushqim. Vetëm ndërhyrja e vëzhguesve të KShH-së pranë shefit të komisarariatit bëri të mundur dhënien e drekës këtij të ndaluar.

Disa sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut

1. Duke vlerësuar situatën konkrete të disa prej institucioneve të vëzhguara, KShH-ja mbështet nevojën e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës së dhomave të paraburgimit që gjenden në ambientet e komisarateve të policisë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2. KShH rekomandon marrjen e masave për të ndryshuar situatën infrastrukturore dhe të kushteve fizike në ambientet e ndalimit dhe të shoqërimit të personave në komisariatet e policisë. Rekomandohet rikonstruktimi i plotë i këtyre ambienteve si edhe pajisja e tyre me mjetet e nevojshme për jetesë.
3. Në institucionet e paraburgimit është e nevojshme të krijohen mjediset për mbajtjen e të miturve dhe të pajisen ato me orenditë e nevojshme.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bazë të vlerësimeve periodike të kapaciteteve faktike në institucione, është e rekomandueshme të marrë masa e nevojshme për zbutjen e mbipopullimit dhe transferimin e personave në institucione përkatëse.
5. KShH-ja vlerëson zbatimin e normave të reja të ushqimit në institucionet e paraburgimit dhe në burgje, por rekomandon që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të organizojë herë pas herë kontrolle nëse këto norma zbatohen në praktikë.
6. KSHH-ja nxit drejtuesit e policisë dhe të prokurorisë që të marrin masa që punonjësit e tyre të respektojnë detyrimin për informimin e personave të privuar nga liria për të drejtat e tyre në momentin e ndalimit ose të arrestimit.
7. Duke vlerësuar rëndësinë e programeve sociale në rehabilitimin social të të dënuarve në përgjithësi është e rekomandueshme që institucionet që rrisin bashkëpunimin e aktorë të shoqërisë civile dhe të institucioneve të tjera jashtë burgut për të organizuar veprimtari social-kulturore dhe të krijojnë më shumë mundësi edukuese nëpërmjet kurseve të ndryshme profesionale etj.
8. Lidhur me gratë e paraburgosura dhe të dënuara, është e rekomandueshme që trajtimi i tyre të bëhen sipas standardeve të përcaktuara në Rregullat Evropiane të Burgjeve, duke u siguruar të gjitha kushtet e nevojshme higjieno-sanitare, orenditë për një trajtim në përputhje me nevojat e tyre. Rekomandohet gjithashtu që të merren masa për funksionimin e marrëveshjes midis Ministrisë së Drejtësisë dhe DPB-së për kryerjen e vizitave gjinekologjike nga mjeku i Poliklinikës Nr.4.
9. Duke vlerësuar rëndësinë e një trajtimi shëndetësor sa më profesional dhe në bazë të standardeve të kërkuar në këtë fushë, rekomandohet hapja sa më shpejt e institucionit të trajtimit të personave të sëmurë mendore në Durrës.
10. Për të përmirësuar shërbimin shëndetësor dhe ligjor është e rekomandueshme që të sigurohet personeli i nevojshëm dhe në sektorë që kanë seksione paraburgimi të shtohet edhe personeli jurist edhe për sektorin juridik, sidomos në institucionet ku ka edhe regjim paraburgimi dhe të merren masa për rriten e aftësive profesionale të tyre.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Address: Rr. Gjin Bue Shpata,
Pll. 5/1, Ap. 4, Tirana-Albania
P. O. Box /Kutia Postare No. 1752

Tel & Fax: ++355 (0)4 22 33 671
e-mail: office@ahc.org.al
web address: www.ahc.org.al